

Data 07.11.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** *Ndërtim i rrjetit të K.U.Z. të lagjeve përreth ujëmbledhësit të Paskuqanit dhe ndërtimi i Rrugës vazhdim "Ali Demi"*

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 45233120-6

**Punime ndërtimi në rrugë**

Afati i realizimit të punimeve është 6 muaj, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të difekteve ,që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

**Vlera e fondit limit:** *157,885,256 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.*

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1.** Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a.** *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

## **2. Kandidat/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2021-2022-2023**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit). *Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022,2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024** ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 % te fondit limit** të perlllogaritur të prokurimit pa tvsh të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të perlllogaritur të prokurimit.

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme.**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certificate e perkoheshme /e perhershme e marrjes ne dorezim
  - Fatura tatimore **të deklaruara në organet tatimore**
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Fatura tatimore **të deklaruara në organet tatimore**
- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.
  - Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Po ashtu, në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vërtetuar përvojën e mëparshme si kontrata e bashkepunimit disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

**2.4** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

- N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P - 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- N.P - 7 D Ujssjellësa , gazsjellësa , vajsjellësa , vepra kullimi e vaditje;
- N.P – 11 A Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

#### **Për punimet speciale të ndërtimit:**

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S – 9 A Punime strukturore speciale
- N.S – 10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale
- N.S – 18 A Punime topogjodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

#### **NP.1 A Punime gjurmimi në tokë**

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore ose zhavorrishte.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i ndërtimit të ri të konceptuar në disa godina ku në katin përdhe janë të bashkuara disa prej tyre në bazë të funksioneve ndëlidhëse. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit dhe sistemimit, kapitulli punimet ndërtimore dhe kapitulli punime hidraulike në preventivin e

punimeve dhe në paragrafët përkatës, punime dheu dhe gjurmimi në specifikimet teknike të punimeve strukturore. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit, **konkretisht 11,539,577 leke sipas preventivit te punimeve.**

#### **NP-4 B Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale**

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime qe përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore. Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 4. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kjo pikë është kërkuar duke patur parasysh se në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve janë parashikuar punime për rrugën e aksesit në objekt L=400 ml. Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është **46,747,841 Lekë pa TVSH**

#### **N.P - 7 D Ujësullës , gazjullës , vajjullës , vepra kullimi e vaditje;**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësullësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është totali i objektit **111,137,415 Lekë pa TVSH**

#### **NP-12 A Punime te inxhinierise se mjedisit**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik. Përfshin në

mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kjo pikë është kërkuar duke patur parasysh se në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve janë parashikuar punime për shkullje bimesh, prerje skarpate, mbjellje skarpate.

#### **NS – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve**

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve. Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është **339,221 Lekë pa TVSH**

#### **N.S - 6: Sinjalistika rrugore jondriçuese**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është **813,804 Lekë pa TVSH**

#### **NS-9 A Punime Strukturore speciale**

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kjo pikë është kërkuar duke patur parasysh se në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve janë parashikuar punime për uljen e nivelit të ujit nëntokesor, stabilizim të strukturës së trupit të rruges, gjeotekstil, mbushje me gur kave dhe punimet e betonit për shkarkues katastrofik. Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është **2,961.000 Lekë pa TVSH**

#### **NS-10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dyschemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin



e projektit të zbatimit. Kjo pikë është kërkuar duke patur parasysh se në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve janë parashikuar punime per veshjen e skarpates, gabioneve, shtresa e betonit per kuroren etj. Vlera e preventivit të punimeve për zërat e përshkruar sa më sipër është **453,902 Lekë pa TVSH**

#### **NS-18 A Punime topogjeodezike**

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objekteve në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kjo pikë është kërkuar duke patur parasysh se në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve janë parashikuar punime per veshjen e skarpates, gabioneve, shtresa e betonit per kuroren etj.

**2.5** Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

*(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes që do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve që ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).*

#### **Argumentimi:**

**Së pari**, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

**Së dyti**, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi

teknik i kantierit”. Gjithashtu, duke qenë se fondi limit për këtë procedurë prokurimi është **157,885,256 lekë pa TVSH**, jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjesi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të ketë një numer mesatar të punonjësve të siguruar jo më pak se **72 (shtatëdhjetë e dy) punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht – Tetor 2024**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Gusht – Tetor 2024**
- Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Gusht – Tetor 2024**

**Shënim:** Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda

afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **72 (shtatëdhjetë e dy) punonjës**, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **6 (gjashtë) muajve**, nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”(periudha në të cilën është hartuar dhe miratuar projekt zbatimi). Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhene garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetimi të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën Gusht 2023, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim të paktën **72 persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

**2.7** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht – Tetor 2024**, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë transport)
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

*Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomik, sipas punimeve që merr persiper të realizojë referuar Preventivit të punimeve, secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë të përfshirë në licencën e shoqërisë.*

**Shënim:** Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve: ndërtimi, hidroteknik, mekanik, topograf, gjeolog, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në

konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-1, NP-4, NP-7, NS-10** është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit të Ndërtimit dhe Inxhinier te Ndertimit (profili infrastrukture transport). Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla , punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës,betonit, hekurit, shtresave te rruges, gabioneve hidroizolimet.Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe plotësimi i kërkesave për mbrojtjen nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetit e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit. Metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standartet dhe kriteret e zbatimit nga inxhinier ndërtimi, i profilit strukturist.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP-6, NP-7 është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit Hidroteknik. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të rehabilitimit te nje objekti hidroteknik, punimet e tubacioneve, e shkarkuesit katastrofik, punime te cilat kerkojne pranine e nje Inxhinieri Hidroteknik.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës, NP-7 është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit Mekanik. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi punimesh per waterstop, kontroll me sonde skanuese lazer, saracineskash.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës, NP-12 është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit të Mjedisit. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi punimesh per shkulje bimesh, prerje bimesh, sistemime skarpatash.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës, NS-18 është domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e Inxhinierit Topograf. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon punime te ndryshme piketimi, rilevimi etj.Duke gjykuar se do te rehabilitohet nje objekt hidroteknik, do te rehabilitohen rruget e aksesit etj, nevojiten rilevime dhe piketime te ndryshme te cilat kane nevojte per prezencen e Ing.Topograf.

**2.8** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf mbeshtetes jo domosdoshmerisht te perfshire ne licensen e shoqerise për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen **Gusht – Tetor 2024**, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

*Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi** Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, të cilat i japin garancitë e nevojshme autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Stafin teknik mbeshtetes (në bashkëpunim me stafin inxhinierik drejtues teknik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi. Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sic parshikohet në pikën 2.8 i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve si dhe referuar në preventivin e Punimeve është e domosdoshme të plotësohet kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi hidroteknik, Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më

komplekset. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet, kriteret e zbatimit nga inxhinier ndërtimi, te profilit strukturist staf mbështetës, nën drejtimin e inxhinierit drejtues teknik. Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve si dhe referuar në preventivin e Punimeve është e domosdoshme të plotësohet kërkesa për 1 (një) inxhinier gjeolog. Për realizimin e projektit, zbatuesi duhet të mbështetet në projektin, relacionin, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve. Punimet duhet të realizohen në përputhje me zgjidhjet teknike dhe specifikimet e projektuesit. Për drejtimin teknik të këtyre punimeve është e nevojshme që të angazhohet një ing. gjeolog për shkak të terrenit dhe natyrës së objektit. Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve si dhe referuar në preventivin e Punimeve është e domosdoshme të plotësohet kërkesa për 1 (një) inxhinier elektrik për shkak të punimeve elektrike në rrugë, punimeve të ndicimit etj.

**2.9** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar e kontratë pune të vlefshme, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga autoritete përgjegjëse të akredituara/licensuara dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht – Tetor 2024**, konkretisht minimumi:

1 (një)	Teknik Ndërtimi
1 (një)	Teknik Topograf
1 (një)	Teknik Hidraulik
1 (një)	Teknik Elektroteknik
2 (dy)	Hekurkthyes
2 (dy)	Karpentierë
4 (katër)	Hidraulikë
3 (tre)	Betonues
2 (dy)	Elektracistë
3 (tre)	Gurëgdhendës
2 (dy)	Saldatorë
3 (tre)	Automakinistë
2 (dy)	Buldozieristë
3 (tre)	Manovratorë/Ekskavatoristë
7 (shtatë)	Shoferë (Drejtues mjete)
25 (njëzet)	Punëtorë

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (Diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:  
kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit

Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën në SPE me të dhënat si më poshtë :

N r.	Emër Mbiemë r i punonjë sit	Profesio ni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplo mës	Nr. Amzes/ diplomes/certifik ates profesionale	nr.nipt dhe nr.license ne rast se subjekti eshte privat	Datat e vlefshmerise se certifikates se sigurimit teknik
1						
2						
etj						

**Shënim:** Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lysterje me bojë



*etj. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.*

*Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.*

- Ne lidhje me 1 (nje) Teknik ndertimi prezenca e tij në kantieret e ndertimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit si (punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e hekurit, punimet e betonit etj.) me sukses
- Ne lidhje me 1 (nje) teknik topograf nisur nga shtrirja e madhe e objektit dhe referuar grafikut të punimeve ku puna do të organizohet paralelisht në disa fronte është e nevojshme prezenca e tyre në kantier për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve në kohe dhe në cilësi.
- Ne lidhje me 2 (dy) punonjes hekurkthyes kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Gjithashtu hekurkthyesit nevojiten për realizimin e punimeve të tilla si matjet e duhura të hekurit duke respektuar tolerancat teknike, prerja e hekurit sipas përmasave të duhura duke eliminuar mbetjet (sa më pak firo), vendosjen e hekurit sipas specifikimeve të projektit, “mbjelljen” e kolonave në bashkëpunim me topografin ose inxhinierin e zbatimit për strukturat vertikale (kolona, mure anësore etj.), montimin (lidhjen) e hekurit sipas specifikimeve të përcaktuara, lidhjen e hekurave të soletës (që mund të jetë monolite ose e lehtësuar), etj.
- Ne lidhje me 2 (dy) punonjes karpentiere kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Të tillë punëtorë realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piktimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalishtet e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit), lagin armaturën para betonimit,

ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës etj.

-Ne lidhje me 4 (katër) punonjes hidraulike kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike

-Ne lidhje me 3 (tre) punonjes betonues sqarojme se sipas zërave të preventivit kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Betonues, sipas Listës Shqiptare të Profesionëve, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj.

-Ne lidhje me 2 (dy) elektrikistë kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të punimeve elektrike. Këtu përfshihen të gjitha punimet elektrike sipas preventivit

-Ne lidhje me 3 (tre) punonjes gurë-gdhendës kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të ndryshme të punimeve të gurit në harmoni me pedonalen të Liqeni Paskuqan etj.

-Ne lidhje me 1 (një) punonjes saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të ndryshme të tubave, për të cilat nevojiten saldatorë për ngjitjen e tyre.

Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar **Manovrator dhe kryesisht 3 (tre) Punonjes Manovratore automakiniste, 2 (dy) Punonjes Manovratore buldozeriste, 3 (tre) Punonjes Manovratore eskavatoriste dhe 7 (shtate) Drejtues mjete** me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gërmimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**.
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën ne SPE me të dhënat si më poshtë :

N r.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. Amzes/ diplomes/certifikates profesionale	nr.nipt dhe nr.lice nse ne rast se subjekt i eshte privat	Datat e vlefshme rise se certifikates se sigurimit teknik
1						
2						
etj						

Kerkesa e paraqitjes se tabelës se detajuar që ne kete faze krijon nje lehtesi per Autoritetin Kontraktor pasi ne kete menyre siguron AK që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem lidhur me profesionalizimin e punonjesve dhe eshte lehtesisht e kontrollueshme per Ak gjate fazes se vleresimit ne reference me dokumentat e paraqitura qe gjate kualifikimit.

**2.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/çertifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **Gusht – Tetor 2024**, të paktën;

- 1 (një) punonjës që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier"*"  
Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara *për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*.

- 1(një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,

**Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.**

**Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.**

**ARGUMENTIM** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Lidhur me kërkesën për 1 (një) Inxhinier i kualifikuar sipas ISO 9712, Inspektor NDT Niveli II, për inspektime VT, MT, UT, RT në përputhje me metodat e reja të testimit, të tilla si termografia infra të kuqe, testimi me matës deformimi, testimi jo-shkatërrues para certifikimit së punimeve të vecanta të saldimit dhe materialeve të celikut, paraqet nevojën e ndjekjes në mënyrë rigorozë dhe vlerësimin e çdo materiali duke kryer testimet pa shkatërrim para implementimit dhe pas implementimit të tyre në vepe për të garantuar cilësinë dhe standartet e kërkuara në relacione dhe specifikimet teknike të projektuesit për saldimet e materialeve që do të përdoren. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike nga perlllogaritja e takojnë 960 ore pune. Kërkesa e mësipërme vjen edhe si rrjedhojë e preventivit të punimeve dhe detajeve të projektit të cilat përcaktojnë se në godina (regjim i hapur edhe regjim i mbyllur) dyert janë metalike me kasa metalike alumini, dorezat metalike dhe mentesha metalike, zgarat e dritareve për regjimet e brendshëm, konstruksione metalike për secilën godinë, rrethimi në zonat e ajrimit, rrethimi në terrenet sportive, rrethimi i jashtëm. Për të gjithë këto elemente metalike që janë pjesë përbërëse të projektit si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e ambienteve të institucionit për çështje sigurie dhe disipline duhet të jenë të atilla që gjatë natës (apo orareve/situatave të ndryshme) të mos lejojnë kalimin nga ambienti i fjetjes, tek ambienti i qëndrimit të brendshëm (salla studimi, dhoma e ngrënies etj) dhe nga ambienti i brendshëm në ambientin e jashtëm (oborr apo ambiente sportive) e vlerësojmë të rëndësishëm prezencën e Inxhinierit të kualifikuar për cilësinë e saldimeve.

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim

realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, dy punonjësit të cilit duhet të jene të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Bazuar dhe në V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime saldimi, punime në prani të ujit, punime në kurore të diges, dhe shtrirjes së gjere të objektit, etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1(një) punonjës *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*".

**2.11** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- **Certifikatë ISO 9001: - Certifikim për menaxhimin e cilesise ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyre që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka arritur si evoluim i kësaj ISO;
- **Certifikatë ISO 14001: - Sistemi i Menaxhial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase

(Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

- **Certifikatë ISO 45001: - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente,** e vlefshme për gjithë periudhen e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

**ISO 9001:** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.12 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”**

Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

**2.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë vijon;**

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 25 ton	3 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 14 ton	3 copë	Në pronësi ose me qira
3	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Buldozier	1 copë	Në pronësi ose me qira
6	Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qira

7	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qira
8	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qira
9	Rul ngjeshes gomë-hekur kapaciteti mbi 18 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Rul ngjeshes gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
11	Rul ngjeshes hekur-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti min 1-3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
12	Rrul asfalti hekur-hekur min 9 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
13	Rrul asfalti gome-hekur min 7 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
14	Rrul asfalti hekur-hekur min deri 3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
15	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 30 ton + Kokë Tërheqëse	1 copë	Në pronësi ose me qira
16	Autobetonierë kantieri vetëngarkuese (mjet teknologjik me targa)	2 copë	Në pronësi ose me qira
17	Autobetonierë	1 copë	Në pronësi ose me qira
18	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
19	Dumper kantieri deri ne 3 m <sup>3</sup>	1 copë	Në pronësi ose me qira
20	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
21	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
22	Eskavator me zinxhirë	4 copë	Në pronësi ose me qira
23	Minieskavator	3 copë	Në pronësi ose me qira
24	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qira
25	Paisje për largimin e ujerave nëntoksore me sistem gjilpërthithëse (Sistemi Well Point i paisur me pompë thithëse, age, kolektor dhe aksesori bashkues) thithëse + tuba	1 copë	Në pronësi ose me qira
26	Mikser rrotullues për nivelimin dhe perforcimin shtresave rrugore	1 copë	Në pronësi ose me qira
27	Paisje për shkulje dhe mbjellje pemesh pa i demtuar min d=60 cm.	1 copë	Në pronësi ose me qira
28	Makineri teknologjike thithëse për pastrimin e mbetjeve kapaciteti 7-9 m <sup>3</sup> .	1 copë	Në pronësi ose me qira
29	Makineri teknologjike zhbllokimi me presion mbi 250 bar, gjatesia 80-100 ml.	1 copë	Në pronësi ose me qira
30	Automjet me skaner lazer dhe regjistrim video me komandim në distancë min. 100 m për kontrollin e tubacioneve.	1 copë	Në pronësi ose me qira
31	Nofull hidraulike për prishjen e strukturave të betonit dhe betonarmes	2 copë	Në pronësi ose me qira
32	Sonda për shpim horizontal (për kalimin e pedonale)	1 copë	Në pronësi ose me qira
33	Betonierë	3 copë	Në pronësi ose me qira



34	Vibrator betoni	3 copë	Në pronësi ose me qira
35	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qira
36	Tranxhë për prerje hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qira
37	Bango për kthim hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qira
38	Frezë Asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qira
39	Sharrë Asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qira
40	Stampa Betoni	40 copë	Në pronësi ose me qira
41	Makineri për vijëzimin e rrugëve me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qira
42	Vegla pune për stampat e betonit (formëdhënëset në formë guri + aksesori mbështetës)	25 copë	Në pronësi ose me qira
43	Pompë betoni stacionere ose e lëvizeshme	1 copë	Në pronësi ose me qira
44	Matrapik	3 copë	Në pronësi ose me qira
45	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qira
46	Saldatriçe	2 copë	Në pronësi ose me qira
47	Motomjet ose agregat për prerjen e bimësisë	2 copë	Në pronësi ose me qira
48	Çekiç pneumatik	1 copë	Në pronësi ose me qira
49	Motogjenerator $\geq 3.5$ kw	1 copë	Në pronësi ose me qira
50	Trencher për hapjen e kanaleve	1 copë	Në pronësi ose me qira
51	Nivelues lazer për nivelim tubacioni	1 copë	Në pronësi ose me qira
52	Impiant Betoni (i pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
53	Fabrikë Asfalti (e pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
54	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi

Mjete dhe paisje të mbrojtëse në punë:

- Kokore mbrojtëse 72 copë
- Jelekë 72 copë
- Fikse Zjarri 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën 2 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 16 copë
- Tabela rrugore (devijim, punime etj) 6 copë
- Kutitë Ndihmë e shpejtë 3 copë

***Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.***

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e noteruar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të mbulojë afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 germa a të ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 i ndyshuar "për prokurimin publik".

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet "Deklaratë" nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nëpërmjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri

dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të vëllimeve dhe grafikut të punimeve pra vërteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- Referuar preventivit të punimeve, për punimet e transportit të dheut apo materiale, punimet e shtresave, punimet e mbushjeve, kërkojnë mjetet kamion vetëshkarkues për realizimin e tyre. Për këto arsye janë kërkuar kamione vetëshkarkues në kapacitet të ndryshëm
- Sipas preventivit të punimeve, një pjesë e madhe e punimeve janë punime germimi dhe për këto janë kërkuar mjetet eskavator me goma dhe zinxhire, minieskavator, damper kantieri, fadrome,
- Sipas preventivit të punimeve, në objekt kërkohet të realizohen punime për rruget e ndryshme në objekt, dhe për këto arsye janë kërkuar mjetet si më poshtë:  
Buldozer, Autobot Uji, Mixer Rrotullues, Rrula ngjeshes të kapaciteteve të ndryshme, Asfaltshtruese, Grejder, Autobitumatrice. Fabrika e Asfaltit, Linja e Inerteve
- Sipas preventivit të punimeve, në objekt do të bëhen punime betoni, punime kalleperie, dhe për këto arsye janë kërkuar autobetonieret, autopompat, betoniere, pompa stacioner e betonit, vibratore betoni, fabrika e betonit etj.
- Sipas preventivit të punimeve, në objekt do të bëhen punime të ndryshme në lidhje me bimesinë dhe për këto është kërkuar Makineri për shkulje pemesh pa i demtuar dhe Motomjet ose agregat për prerjen e bimesisë sipas preventivit
- Sipas preventivit të punimeve, kërkohet të kryhet largim ujërash nëntokesore për të mundësuar punimin në ujëmbledhës, për këto arsye është kërkuar Sistem Wellpoint
- Sipas preventivit, për punimet e kanalizimeve, për të realizuar punimet e pastrimit, kontrollit, zhbllokimit etj, janë kërkuar mjetet Makineri teknologjike thithese për pastrimin e mbetjeve kapaciteti 7-9 m<sup>3</sup>, Makineri teknologjike zhbllokimi me presion mbi 250 bar, gjatesia 80-100 ml, Automjet me skaner lazer dhe regjistrim video me komandim në distancë min. 50m për kontrollin e tubacioneve, sonda për shpim horizontal.
- Sipas preventivit të punimeve, për realizimin e punimeve të ndryshme në objekt, për punimet e tubave, hekurit, prishjeve, etj kërkohen mjetet e tjera të kërkuara si Betoniere, Vibrator betoni, Tokmak ngjeshes, Tranxhe për prerje hekuri, Bango për kthim hekuri, Matrapik, GPS, Saldatrice, Çekiç pneumatic, Motogjenerator etj
- Për sigurinë në kantier dhe për puntetoret, janë kërkuar jeleket, kokoret, fikaset e zjarrit dhe kompletet e ndihmes së shpejte.

**2.14** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet Tuba dhe Materiale Elektrike sipas Preventivit. Për materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skadat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në cilësi të kontratës për këtë object sipas standarteve te kerkuara ne specifikimet teknike. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojte qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punime që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve AK ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallarave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me çertifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si

autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie ,certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara janë të harmonizuara me Standardin European.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe ose gjuhën angleze. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip si dhe të jenë të certifikuar "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë perberese e strukturës së **Bashkisë Kamez**, që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke përfshirë elemente perberese të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit" i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose*

*originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

## **Njësia e Prokurimit**